Ne perputhje me ligjin ne fuqi te Shqiperise, nuk lejohet qe ne te njejten kohe antaret e Keshillit Mbikqyres te jene anetare te Drejtorise. Ne rast te kundert, anetari i Keshillit Mbikqyres qe eshte dhe anetari i drejtorise automatikisht humbet te drejten e te qenurit i Keshillit Mbikqyres. Keshilli mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme, pa qene e pranishme te pakten gjysma e anetareve te tij.

NENI 11

KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres mund te marre vendime edhe me anen e korespondences me telex ose telegram ne qofte se asnjeri nga anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk ka kundersizim per kete procedure.

Ruhen protokollet e mbledhjes se Keshillit Mbikqyres si dhe vendimet qe jane marre jashte mbledhjeve d.m.th. me korespondence. Dosjet nenshkruhen nga kryetari i Keshillit Mbikqyres ose zevendesi i tij.

Me propozimin e drejtorit te pergjithshem, Keshilli Mbikqyres percakton kapitalet e shoqerise dhe vlefte te tyre perkatese.

Me propozimin e drejtorit te pergjithshem, keshilli mbikqyres miraton rrogat e personelit si dhe numerin e personelit.

Keshilli Mbikqyres afron per shitje ose blerje elemente pasurore ose lidh kontrata per blerje, shitje te elementeve pasurore ose çdo marrveshje me te tretet deri ne 30.000.000 leke ne vit.

Keshilli Mbikqyres eshte kompetent qe te parashtroje ne asmamblene e pergjitheshme te aksionereve keto çeshtje:

Ndryshime ose shtesa ne kontraten e krijimit ose ne statutin e shoqerise.

Miratimin e buxhetit vjetor te shpenzimeve rrjedhese, miratimin e raportit vjetor te administrates si dhe raporteve te tjetra ekonomike qe parashikon ligji, ndarjen e pjeseve te fitimit ose llogaritjen e sakte te humbjeve brenda afatit gjashte mujor qe nga mbarimi I vitit ekonomik.

Lidhjen e marrveshjeve me te tretet (per import eksport), dhenjen e garancive dhe lidhjen e marrveshjeve per akordim huaje ose valute, Hipotekim nga shuma prej 500.000 leke deri ne 2.000.000 leke ne vit ose ne kundravlefte ne EU ne baze te kursit zyrtar diten kur kryhet veprimi.

ANETARET E KESHILLIT MBIKQYRES.

Bledar Teqja
Kujtim Ymeri
Bujar Hasa

Kryetar
Anetar
Anetar

NENI 12

KOMPETENCAT E DREJTORISE

Drejtoria

Drejtoria perbehet nga dy anetare:

- a. Drejtori i pergjithshem
- b. Zevendes drejtori

Drejtoria eshte organi ekzekutiv i shoqerise, drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine tek te tretet, ne perputhje me kontraten e krijimit dhe te statutit.

Drejtor i Shoqerise emerohet z. Dionis Teqja.

Drejtori i pergjithshem dhe zv. drejtori emrohen per nje afat dy vjeçar. Afati mund te zgjatet me vendim qe merret me shumicen e thjeshte.

Ne rast te zbatimit te detyrave me pasoja per funksionimin e shoqerise, Keshilli

Mbikqyres ka te drejte te pushoje drejtorin e pergjithshem para afatit. Vlerisimi i perfundimeve te drejtorit te pergjithshem behet nga Keshilli Mbikqyres mbi baze te te dhenave (vleresimeve) qe jepen nga eksperti kontabel.

Ne kompetencat e drejtorit te pergjithshem bejne pjese :

- a. Mundesia e lidhjes se kontratave te çdo lloji ne emer te shoqerise me persona juridike e fizike ne teritorin e Shqiperise ose jashte saj. Marreveshjet me kontratat qe nenshruhen nga drejtori duhet te kene parapelqimin e keshillit mbikqyres ose te asamblese se aksionereve sipas dispozitave te percaktuara ne statut.
- b. Emertimi dhe pushimi i personelit te perhershëm dhe te perkohshëm te shoqerise ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi.
- c. Perpilimi dhe parashtrimi ne Keshillin Mbikqyres i raporteve ekonomike dhe lidhja me veprimtarine e shoqerise. Rregullat e perpilimit te ketyre raporteve vendosen nga keshilli mbikqyres.

Librat e shoqerise si dhe ekstraktet e llogarive ruhen ne qendren e shoqerise.

KREU IV

DIPOZITA EKONOMIKE

NENI 13

KAPITALI BAZE / AKSIONET

Per te siguruar funksionin normal te shoqerise kapitali themeltar i saj eshte **620.000.000 LEK** (Gjashte qind e njezet milion) leke , ne natyre ,i ndare sipas kontributeve te aksionereve .

Dionis Teqja 10 % (dhjete) = 63.000 (aksione)

Shoqeria " A.Teqja " SHPK 90% (nentedhjete) = 557.000 (aksione)

Aksioneret disponojne aksione nominale te meposhteme :

Dionis Teqja _____

63.000 aksione baraz me 63.000.000 Lek (truall,toke)

Shoqeria " A.Teqja " SHPK _557.000 aksione baraz me 557.000.000 leke(makineri dhe paisje) ne baze te raportit te ekspertit kontabel te autorizuar dhe raportit te vleresimit te pasurise sepelujtshme

Vlera nominale e nje aksioni eshte 1000 leke .

Shoqeria mban libra te vecanta per emertimin e aksioneve (ne perputhje me dispozitat e ligjshmerise shqiptare) ku shenohen:

- data e veprimit
- emri dhe mbiemri i aksionerit
- numri dhe vlera nominale e aksioneve

Aksionete e shoqerise jane te pandashme, ndersa shoqeria njeh vetem nje pronar per cdo aksion.

Çmimi i nxjerrjes se aksioneve te rinj ne rastin e rritjes se kapitalit mund te jete me I larte se vlefte emertuese e tyre por asnjehere me I ulet.

Ne baze te ligjeve ne fuqi aksioneri kontribuon ne formimin e kapitalit baze te shoqerise me para, ndertesa dhe instalime paisje etj.

Me kalimin e kontributeve nga aksioneret ne kapitalin baze Keshilli Mbikqyres I shoqerise I jep cdo aksioneri vertetimin perkates.

Nga momenti I vendosjes se kontributit ne kapitalin baze shoqeria fiton te drejten e paisjes, perdorimit dhe disponimit te ketij elementi pasuror ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.

NENI 14

VITI EKONOMIK

Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te vitit kalendarik.

NENI 15

Dhenia e llogarise ekonomike.

Shoqeria funksionon mbi bazen e dispozitave te vecanta dhe te programeve qe jane miratuar nga asambleja, keshilli mbikqyres, drejtoria te percaktuara ne statut.

Shoqeria mban ne menyre te pa varur librat e saj ekonomike dhe situacionet.

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbeshket ne llogarine e veprimit, vetfinancimit dhe mbulon shpenzimet dhe arketimet e veta duke perfshire edhe ato me valute.

Kontrolli I perditeshem kontabel dhe statistikor behet mbi bazen e dispozitave qe veprojne ne Shqiperi.

Librat kontabel mbahen ne gjuhen shqipe nga eksperti kontabel I emeruar nga asambleja e pergjitheshme (persona fizike e juridike) qe vene ne dijeni asamblene dhe keshillin mbikqyres.

Eksperti kontabel i autorizuar i shoqerise eshte caktuar zj. Ajketa Shkemi .

Shumat ne leke ne valute konvertohen perkatesisht me kursin zyrtar te asaj dite qe behet kembimi.

Brenda tre muajve nga mbarimi i vitit ekonomik drejtori i pergjithshem ben bilancin dhe nxjerr perfundimet e veprimtarise (fitimet e humbjet) te vitit te kaluar.

Me qellim qe te ushtroje te drejten e kontrollit, cdo aksioner ka te drejte te marri informata dhe te kontrolloje cdo ceshtje qe i takon veprimtarise s e shoqerise. Cdo aksioner gezon te drejten ne cdo kohe te marri njoftime per shkresat e shoqerise dhe te dhenat pasurore me qellim qe te ushtroje cdo kontroll mbi te.

NENI 16

KONTROLI KONTABEL

Shoqeria mban libra kontabil per te regjistruar te gjitha veprimet e saj ne baze te udhezimeve te pergjitheshme kontabel qe veprojne ne Shqiperi.
Librat kontabile kontrollohen çdo vit nga eksperti kontabel i cili emrohet dhe vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 17

KREDITE (HUATE)

Shoqeria ka te drejte te marri kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat Shqiptare dhe te huaja ne baze te legjislacionit shqiptar dhe te huaj, ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe te procedurave te ketij statuti.

NENI 18

TRANSFERIMET (TJETERSIMI) I AKSIONEVE

Kufizimi i pergjithshem i te drejtave te kalimit.

Aksioni nominativ u transferohet te treteve dhe personit juridik emetues nëpërmjet nje transferimi ne regjistrat qe shoqeria mban per kete qellim dhe qe permbajne treguesit perkates te operacioneve te transferimit dhe te shnderrimit te aksioneve e ne veçanti :

- daten e operacioneve;
- emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit te titullarit te vjeter dhe atij te ri ne rast transferimi;
- emrin, mbiemrin dhe adresen e banimit te titullarit te aksioneve, ne rast shnderrimi te aksioneve per pruresin ne aksione nominative;
- vleren nominale dhe numrin e aksioneve te transferuar ose te shnderruar.

NENI 19

NDARJA E FITIMIT

Shoqeria ndan fitimet neper aksioneret proporcionalisht me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin baze te shoqerise. Shoqeria do te kete fitimet nga shitjet ne tregun vendas dhe te jashtem ne perputhje me qellimet e aksionereve.

Aksioneret mund te rinvestojne fitimet e tyre ne teritorin e Shqiperise ne baze te ligjeve ne fuqi ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Me propozimin e keshillit mbikqyres asambleja aksionereve mund te zgjeroje veprimtarine e shoqerise ne veprimtari te tjera ne teritorin e Shqiperise dhe jashte saj.

KREU V

RASTE TE PRISHJES SE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 20

Raste te prishjes se veprimtarise se shoqerise.

Prishja e shoqerise behet ne rastet qe vijoje:

- Kur mbaron afati I saj pervec rasteve kur asambleja e aksionereve ka shtyre afatin.
- Kur shoqeria shpallet ne gjendje falimentimi.

- Dalja e nje vendimi nga organet kompetente qe ndalon veprimtarine e shoqerise ne qofte se nje funksionim i tille vjen ndesh me ligjin dhe gjate kohes qe vepron vendimi.
- Marrja e vendimit unanim nga aksioneret.

NENI 21

PROCEDURA E LIKUIDIMIT

Pas prishjes se shoqerise, shoqeria vihet nen likuidim. Mbledhja e pergjitheshme e aksionereve cakton komisionin e likuidimit. Nga çasti i emrtimit te komisionit te likuidimit te gjitha kompetencat e shoqerise I kalojne ketij komisioni sipas ligjit.

Komisioni I likuidimit perbehet nga 4 anetare. Cdo aksioner cakton nje antar dhe i 5-ti qe luan rolin e gjyqtarit te pa varur zgjidhet nga 4 anetaret e lartpermendur. Ne qofte se brenda 40 diteve pas procedures se dorezimit te njoftimit per prishjen e funksionimit te shoqerise ne baze te procedures se nenit te ketij statuti.

Anetarete e komisionit te likuidimit bejne punen e tyre bashkarisht dhe jo vecmas. Me mbulimin e te gjithë detyrimeve te shoqerise duke perfshire edhe ndaj aksionereve dhe detyrimeve te shoqerise dhe detyrimeve te tjera eventuale (rroga) si dhe shperblimin e komisionit te likuidimit, parate nga likuidimi ndahen midis aksionereve proporcionalisht me kontributin e tyre ne kapitalin baze.

KREU VI

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

NENI 22

Ndryshimet e favorshme ne legjislacionin shqiptar.

Ne qofte se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, dekrete ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni ekzistues gjate kohes se vendosjes se shoqerise atehere aksioneret kane te drejte tju drejtohen organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem.

NENI 24

Personeli I shoqerise

Keshilli Mbikqyres I shoqerise miraton perberjen e personelit te shoqerise pas raportimit perkates nga drejtori I pergjithshem.

Shoqeria persa I perket personelit zbaton legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 25

Ky statut i perpiluar nga aksioneret hyn ne fuqi nga momenti qe ata e kane nenshkruar. Aksioneret nenshkruajne sipas rregullave te percaktuar ne ligj.

AKSIONERET THEMELUES

DIONIS TEQJA



SHOQERIA "A. TEQJA" SHPK
Perfaqesuar nga administratori
DIONIS TEQJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2226 Rep.

Nr. Kol

VERTETIM

Sot me date 03.06.2004 (dymije e kater) para meje noteres Fatmara N. Shehu ,me seli ne Rr. Bul: " Gjergj Fishta ", u paraqiten personalisht :

Dionis Teqja, i biri i Ahmetit, lindur me 1969 ne Peqin, banues ne Tirane, Rr. Bajram Curri, nr. 70, me pasaporte Nr. 1778596.

2. Shoqeria " A.TEQJA " SHPK, regjistruar ne gjykaten e Tiranes, m me vendimin nr. 13668 date 6.2.1996, me seli ne Rrogozhine, perfaqesuar nga administratori

Dionis Teqja, me pasaporte nr. 1778596.

Madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklarojne se sa siper, kane nenshkruar sipas ligjit , une noteri e vertetoj sipas ligjit.



NOTER
/ FATMARA SHEHU /

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TEAKSIONIEREVE TE
SHOQERISE TEQJA INTERNATIONAL SHA.

VENDIM NR. 1 DATE 05.07.2004


Sot ne Tiran, me date 05.07.2004, ne adresen rr. "Deshmoret e
4 Shkurtit " ,Kompleksi " Green Park", kulla 2, kati 12,
Tirane, u mblodh Asambleja e jashtezakonshme e aksioniereve
te shoqerise " Teqja International " SHA.
Ne mbledhje ishine te pranishem aksioneret qe perfaqesonin te
gjithe kapitalin e shoqerise si vijon:
z. Dionis Teqja qe zoteron 63.000 aksione
A.teqja SHPék, qe zoteron 557.000 aksione,

V E N D O S I :


1. Miratimi i transferimit te 28.227 aksioneve nga
aksionieri Dionis Teqja tek Fondi Shqiptaro - Amerikan i
Ndermarrjeve, perfaqesuar nga Jeffry T.Griffin
nepermjet kontrates se dhurimit.
2. Aksioniere te shoqerise behen:
 - Dionis Teqja me 34.773 te aksioneve te shoqerise
 - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve, me 28.227 te
aksioneve.
 - "A.Teqja", shpk, me 557.000 te aksioneve.
3. Te pasqyrohet ky ndryshim ne zyre e regjistrimit tregtar.

AKSIONIERET

DIONIS TEQJA



A.TEQJA SH.P.K.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " A. TEQJA " SHPK
SELIA RROGOZHINE

V E N D I M

NR. 1 DATE 02.06.2004

Une, Dionis Teqja, administratori dhe ortaku i vetem i shoqerise " A. Teqja " SHPK, rregjistruar ne gjykatën e rrethit Tirane, me vendimin nr. 14668 date 06.02.1996, me seli ne Rrogozhine,

V E N D O S A :

1. Te bashkohem me ane te kontributit pjesor me aktive (makineri, pajisje, ndertesa) me vlere 90 % te aksioneve dhe krijim shoqerie te re te quajtur " TEQJA INTERNATIONAL " sha.
- Kapitali i shoqerise " Teqja International " sha formohet me kontributin e aksionerve :
 1. Dionis Teqja, 10 % te aksioneve, i cili ve ne dispozicion ne forme kapitali token dhe truallin te vleresuar nga nje ekspert vleresues, dhe
 2. Shoqeria " A. Teqja " SHPK, me 90 % te aksioneve, i cili ve ne dispozicion ne forme kapitali makineri, pajisje, ndertesa, te vleresuar nga nje ekspert kontabel i autorizuar.
 3. Te pasqyrohet ky ndryshim ne zyren e regjistrimit tregtar.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

DIONIS TEQJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 38/4 Rep.

Nr. 12/13 Kol.



KONTRATE PER DHURIMIN E AKSIONEVE

Sot, me 5 korrik 2004, perpara meje noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten palet e meposhtme te cilet te lidhin kete Kontrate per Dhurimin e Aksioneve (me poshte quajtur "Marreveshja"):

Z. DIONIS TEQJA, shtetas shqiptar, lindur ne Peqin me 25.06.1969, mbajtes i pasaportes nr. 1778596, banues ne adresen Rr. Bajram Curri, Nr. 70, Tirane (me poshte i quajtur "DHURUESI").

Dhe

ALBANIAN AMERICAN ENTREPRISE FUND (AAEF), entitet pa-qellim-fitimi, krijuar sipas legjislacionit te shtetit Delaware, Sh.B.A, me seli ne Kompleksin Green Park, Kulla 2, kati i 12-te, Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit, Tirana, Albania, perfaqesuar nga Z. Jeffrey T. Griffin reta Angjeli, e njohur personalisht prej meje Noterit, e autorizuar nepermjet prokures se posaçme, date 03.03.2004, nr.1062 rep., nr.341 kol (me poshte i quajtur "Pranuesi").

MEQENESE

- A. Dhuruesi eshte pronar i 63.000 (gjashtedhjetë e tre mije) aksioneve te nenshkruara dhe te shlyera prej tij (me poshte quajtur "Aksionet e Dhuruesit") ne kapitalin e shoqerise TEQJA INTERNATIONAL SHA., e cila eshte shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit shqiptar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), me seli ne Rrogozhine, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendim nr. 31737 date 10.06.2004 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me kapital themeltar Leke 620.000.000 (gjashteqind e njezete milion), te ndare ne 620.000 (gjashteqind e njezete mije) aksione me vlere nominale Leke 1.000 (njemije) secili, te zoteruara nga aksioneret si me poshte:
 - i. Z. Dionis Teqja, 63.000 aksione
 - ii. A.TEQJA SHPK., 557.000 aksione.
- B. Dhuruesi deshiron t'i dhuroje Pranuesit 28.227 (njezete e tete mije e dyqind e njezete e shtate) nga aksionet qe zoteron dhe Pranuesi pranon aksionet e Dhuruesit.
- C. Asambleja e Aksionareve te Shoqerise date 5 korrik 2004, ka aprovuar transferimin e nje pjese te aksioneve nga Dhuruesi dhe Pranuesi.



Duke patur parasysh sa me lart palet bien dakort per sa vijon:

NENI 1

TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Dhuruesi, nepermjet nenshkrimit te kesaj Kontrate, i dhuron Pranuesit dhe Pranuesi pranon te nepermjet nenshkrimit te kesaj Kontrate pranon dhurimin e 28.227 aksioneve te nenshkuara dhe shlyera nga Dhuruesi ne kapitalin e Shoqerise. Rrjedhimisht, me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Pranuesi behet pronar i 28.227 aksioneve, Dhuruesi mbet pronar i 34.773 aksioneve ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 2

DEKLARIME DHE GARANCI

2.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton se: (i) ai eshte pronar i vetem dhe i ligjshem objekt i kesaj Kontrate dhe keto aksione jane te regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregtar dhe jane te lira nga çdo barre apo e drejte e te treteve; (ii) Dhuruesi ka nenshkruar dhe shlyer teresisht aksionet e tij; (iii) kjo Kontrate perben nje instrument detyrues dhe te zbatueshem per Dhuruesin.

2.2 Pranuesi deklaron dhe garanton se: (i) eshte nje entitet jo-fitim-prures, i krijuar dhe regjistruar sipas ligjit te shtetit Delaware ne USA. (ii) Dhuruesi ka nenshkruar plotesisht dhe shlyer te gjitha Aksionet e Dhuruesit, (iii) kjo Kontrate perben nje instrument detyrues dhe te zbatueshem per Pranuesin.

NENI 3

TE NDRYSHME

3.1 Secila prej paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin dhe ekzekutimin e transaksioneve te parashikuara ne kete Kontrate.

3.2 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruset ne kater kopje ne gjuhen angleze dhe kater kopje ne gjuhen shqipe dhe ky akt perben te gjithe marreveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese palet nuk japin pelqimin e tyre dhe nese kjo nuk konfirmohet me ane te nje marreveshjeje me shkrim te nenshkruar nga perfaqesuesit e tyre te autorizuar.



NENI 4

LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

4.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate dhe qe mund te rrjedhin prej saj, do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.

4.2 Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimueshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.


4.3 Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin e kesaj Kontrate, versioni ne gjuhen angleze do te merret ne konsiderate.

Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem paleve. Jeffrey T. Griffin, i asistuar nga perkthyesi i njohur prej meje noterit dhe i pranuar prej tij, dhe Z. Dionis Teqja, pasi me deklaruan se teksti i ketij akti eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, sot me date 5 korrik 2004.

PRANUESI

ALBANIAN-AMERICAN
ENTERPRISE FUND

Perfaqesuar nga:



F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA

Z. Jeffrey T. Griffin

President dhe CEO i AAEF

DHURUESI


Z. Dionis Teqja






PERKTHYESI

NOTERI





FONDI SHQIPTAR AMERIKAN ENTREPRISE FUND (AAEEF)

Nga takimi i Bordit te drejtoreve te Fondit Albanian - Amerikan Enterprise Fund , (AAEE) organizate Jofitimprure e krijuar sipas legjislacionit te shtetit Deleware USA, me seli ne, sot me date

VENDOSI :

1. Fondi Amerikan Shqiptar i Ndermarrjeve (AAEE), te behet aksioner tek shoqeria "Teqja International " SHA,perfaqesuar nga drejtori ekzekutiv z.Dionis teqja , me seli ne Rrogozhine, shoqeri shqiptare.
2. Te pranoje 28.227 aksione nga aksionieri Dionis Teqja ne shoqerine " Teqja International " Sha, nepermjet kontrates se dhurimit.
3. Te zmadhohet kapitali i shoqerise Teqja International " SHA.
- 4.Caktohet z. Jeffry T. Griffin qe te nenshkruaje dokumentacionin ligjor me z. Dionis Teqja, per kalimin e pronesise se aksioneve ne emer te Fondit Shqiptaro - Amerikan i Ndermarrjeve, si dhe te nenshkruaje cdo marreveshje dhe te marre vendime ne emer te Fondit Shqiptaro Amerikan te Ndermarrjeve me shoqerine " Teqja International " Sha.

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " TEQJA INTERNATIONAL " SHA

VE N D I M
N 2. DATE 21.09.04

Ne Tirane, sot me date 21.09.2004
Asambleja e Jashtezakonshme e aksionareve te shoqerise
" Teqja International " Sha, Z. Dionis Teqja, shoqeria "A.
Teqja "Shpk, Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve, me
adresen RR. deshmoret e 4 Shkurtit ", Kompleksi " Green Park ",
Kulla 2, Kati 12, Tirane, perfaqesuar me prokuren e posacme Nr.
3927 Rep. Nr. 1218 Kol. Date 06.07.04 ,e leshuar ne zyren e
noterise Tirane, notere M.Sadushaj nga z. Martin Mata.

VENDOSEM:

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise.
2. Caktimin e zj. Ajeta Shkempi, eksperte per zmadhimin e kapitalit.
3. Ndryshime ne statutin e shoqerise:

1) "Ne fund te nenit 18 shtohet paragrafi me permbajtjen e meposhtme:

-Aksionet jane lirisht te transferueshme sipas menyres se parashikuara ne ligj me perjashtimin te rasteve te parashikuara ne Marreveshjen e investimit te lidhur midis Fondit shqiptaro-Amerikan te ndermarrjeve dhe aksionareve te tjere te Shoqerise dhe vete Shoqerise, me daten 5 korrik 2004, e cila i bashkengjitet statutin si pjese perberese e tij.

II) Ne nenin 10, pas fjalise se dyte, shtohet paragrafi me kete permbajtje:

"Dy te tretat e anetareve te Keshillit Mbikqyres emerohen me vendim unanim te Asamblese e Aksionareve ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithë kapitalin e shoqerise. Kurse , nje e treta e anetareve te Keshillit Mbikqyres zgjidhen nga rradhet e punemarresve te shoqerise, sipas dispozitave te parashikuara ne ligjin Nr.7638 , date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ". Anetaret zgjedhin midis tyre Kryetarin dhe zevendes kryetarin e keshillit mbikqyres.

Anetaret e keshillit mbikqyres mund te riemerohen dhe/ose te rizgjidhen.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionareve mund te shakrkohen ne cdo kohe me vendim unanim te Asamblese se Aksionareve ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithë kapitalin e shoqerise. Kurse anetaret e zgjedhur te Keshillit Mbikqyres mund te shkarkohen sipas menyrave te parashikuara ne ligjin nr. 7638, date 19.11. 1992 " Per Shoqerite Tregtare ".

III) Ne fund te nenit 10 nen titull Menyra e zgjedhjes- Afati, shtohet nje paragraf me permbajtjen qe vijon:
" Pavaresisht nga sa eshte parashikuar me siper ne kete nen, Keshilli Mbikqyres do te marre me unanimitet te anetareve te pranishem, me kusht qe ne mbledhje jane te pranishem ose te perfaqesuar te gjithe anetaret e keshillit mbikqyres, vendimet e meposhtme:

- a. vendime ne lidhje me investimet e shoqerise.
- b. vendime per emerimin dhe shkarkimin e Drejtoritte pergjithshem apo stafit tjeter drejtues te shoqerise.
- c. Shitjen e asetave te shoqerise apo blerjen e asetave nga shoqeri te tjera".

IV) Ne fund te nenit 8 shtohet paragrafi me permbajtjen e me poshtme:

" Pavaresisht nga sa eshte parashikuar me siper ne kete nen apo ne cdo nen tjeter te Statutit, vendimet per miratimin e strategjive te zhvillimit afatgjate te shoqerise, per miratimin e plan biznesit dhe planit financiar vjetor te shoqerise, per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise, per percaktimin e shumes se dividendit dhe shperndarjen dhe destinimin e me shume se 50 % te dividendit vjetor dhe per emerimin dhe shkarkimin e anetareve te keshillit mbikqyres, per prishjen, likuidimin, bashkimin apo ndarjen e shoqerise, merren me unanimitet ne mbledhje ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e shoqerise ».

V) Ne fund te nenit 19 shtohet paragrafi me kete permbajtje:
" Ky nen do te zbatohet ne perputhje me kufizimet e parashikuara ne marreveshjen e Investimit date 5 korrik 2004, te lidhur midis Aksionareve, Fondit dhe vete Shoqerise".

4. Miratimi i doreheqjes se anetarit te keshillit mbikqyres z. Bujar Hasa dhe emerimi ne vend te tij z. Jeffrey T. Griffin, shtetas amerikan, lindur ne Georgia (USA) me 14.06.1944, mbajtes i pasaportes nr. 71033338, banues ne Tirane (anetar i percaktuar vnga Fondi).

5. Te ndryshme

Asambleja e aksionareve vendosi me unanimitet qe te ngarkoje Drejtorin e shoqerise z. Dionis Teqja dhe t'i jape kompetenca te plota per te pergatitur nenshkruar dhe zbatuar marreveshjen e investimit dhe cdo dokument tjeter qe nevojitet per te realizuar zmadhimin e kapitalit te shoqerise, si dhe per te rregjistruar sa me siper ne Regjistrin tregtar prane Gjykates se shkalles se pare Tirane.

AKSIONARET

DIONIS TEQJA

"A. TEQJA" SHPK

FONDI SHQIPTARO- AMERIKAN I NDERMARRJEVE
Perfaqesuar me prokure nga

Martin Keta



PROJEKTE MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT ME PARA NE DORE

ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE SHOQERISE

“TEQJA INTENATIONAL” SH.A. KAJAVE

Me vendim te dates 15.06.2004, te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise “TEQJA INTERNATIONAL” Sh.A Kavaje, me eshte drejtuar mua si Eksperte Kontabel e Autorizuar, me nr 6 date 10.02.2000, te licenses, per te paraqitur nje projekte mbi zmadhimin e kapitalit me para ne dore

Une si Eksperte Kontabel e Autorizuar, e pranova misionin e percaktuar ne vendimin e Asamblese se Aksionereve, duke patur parasyshe kerkesat e nenit 168,169 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, “Per shoqerite Tregtare”, mbi papajtueshmerite mbi emerimin e Ekspertit kontabel te autorizuar.

Per te kryer kete misione,nga ana e shoqerise me eshte vene ne dispozicion , pasqyrat financiare te ushtrimit 2004, vendimet e asamblese kontratat, si dhe te gjitha dekumentat e tjera qe e bene te besueshem kete projekte.

Ne cilesine time si Eksperte Kontabel e Autorizuar dhe ne zbatim te misionit te parashikuara nga neni 150 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”, po ju paraqesim raportin tone mbi projektin e zmadhimit te kapitalit.

MOTIVET E ZMADHIMIT

Aksioneret e Shoqerise "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A , kane percaktuar arsyet dhe rruget qe do ndiqen per zmadhimin e kapitalit:

Arsyet jane:

1. Te beje te mundur, per te siguruar kapital te ri per te financuar investimet e programuara, e cila veretohet sipas MARREVESHJES SE INVESTIMIT date 05.07.2004, te nenshkruar nga te gjithë aksionerte e shoqerise, si me poshte:

a..**Shoqeria "A.TEQJA sh.p.k**, e krijuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise ,me vendim nr 13668 date 06.02.1996, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

b. **Z. DIONIS TEQJA**, shtetas shqiptare, lindur ne Peqin me date 25.06.1969, mbajtes pasaporte me nr 1778596, banues ne adersen Re. Bajram Curri, nr 70, Tirane:

c.**FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE(AAEF)**
Organizate jofitimprurese e krijuar sipas legjislacionit te shtetit Delaware,U.S.A me seli ne Rr "Deshmorte e 4 shkurtit ", Kompleksi "Green Park",kulla 2, kati 12, Tirane Shqiperi, e perfaqesuar nga Z.Jeffrey.Griffin ne cilesin e President dhe CEO.

2. Shoqeria kerkon te rrise besueshmerine e saj, si ne tregjet e brendeshem te jashtem dhe ato financiare.

Rruga qe do te ndiqet:

Ne kete marreveshje eshte percaktuar edhe rruga qe do te ndiqet per zmadhimi I kapitalit, e cila konsiston ndermjete emetimit te aksioneve te reja qe do te shlyen me para ne dore

B. MONDALITETET DHE RREGULLAT E ZMADHIMIT

Sipas nenit 150 te ligjit 7638 date 19.11.2002, "Per shoqerite Tregtare", mondalietet e zmadhimit kane te beje:

1. Me menyren e realizimit te zmadhimit te kapitalit e cila konsiston:

a. Ne hartimin e buletinit te nenshkrimtit te aksioneve te reja te emetuara nga shoqeria "TEQJA INTERNATIONAL" Sh.A (sipas nenit 159 te ligjit) date 05.07.2004

b. Zmadhimi I kapitalit do te realizohet ndermjete emetimi te aksioneve te reja ne shumen prej 158.690.000 leke, ose 158.690 aksione me vlere nominale 1000 (nje mije leke) secili..(sipas nenit 160 te ligjit)

c. Derdhja e aksioneve te reja ne para eshte bere sipas certifikates se depozitimit te fondit ne Banken Amerikane te Shqiperise date 06.09.2004,(sipas nenit 161 te ligjit)

2 .Me menyren e shlyrjes se aksioneve te emetuara ne kuadrin e nje zmadhimi te kapitalit themeltare.

a. Mondaliteti i shlyrjes se aksioneve te reja, eshte me para ne dore

KUSHTET PARAP RAKE

Sipas nenit 154, perpara se te behet cdo emetim I aksioneve te reja qe shlyen me para ne dore, duket qe kapitali I nenshkruar perpara zmadhimit te jete derdhur efektivishte ne llogarin e Shoqerise , dhe konkretishte

Shoqeria "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A. gezon personalitet juridik sipas vendimit nr 31737 date 10.06.2004. te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Me nje kapital te nenshkruar ne shumen prej 620.000.000 leke e ndare ne aksione 620.000 aksione, keto aksione zoterohen nga aksioneret e meposhtem:

Nr	AKSIONERET	%Kapitalit	Nr aksioneve	Vlera nominale	Vlera e kapitalit
1	Dionis Teqja	10	63.000	1.000	63.000.000
2	Shoqeria "A.TEQJA" sh.p.k	90	557.000	1.000	557.000.000
	TOTALI	100	620.000	1.000	620.000.000

Keto aksione jane shlyer tersishte nga aksioneret, ne shumen prej 620.000.000 leke e vertetuar edhe nga me bilanci kontabel si me poshte:

AKTIVI

PASIVI

a. AQT	Vlefte	Kapitale veta	Vlefte
1. Ndertesa	112.500.000	1. Kapitali I nenshkruar	620.000.000
2.Makineri dhe paisje	557.000.000		
TOTALI	620.000.000	TOTALI	620.000.000

VERIFIMIMI I AKTIVEVE DHE PASIVEVE(detyrimet)

Meqense Shoqeria "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A, e cila pa mbushur akome dy vjete nga data e themelimit kerkon te procedoje ne nje zmadhim te kapitalit, eshte e detyruar qe te kryeje paraprakishte verifiminin e aktiveve dhe pasiveve te saj.

Kjo dispozite e ligjit synon qe tu jape te treteve te ftuar per ta marre pjese ne zmadhimin e kapitalit nje informacion me te sakte mbi situaten e kapitaleve te shoqerise.

Per kete dispozite, jape nje opinion pa rezerva pasi une si Eksperte Kontabel dhe Eksperti Vleresues , kemi hartuar Raportin e Bashkimit me Kontribute te Pjeshme ne Aktive dhe Raportin e Vleresimit, te shoqerise "A.TEQJA" sh.p.k ne shoqerine "TEQJA INTERNATIONAL" Sh.A, me date 01.06.2004, ku jane percaktuar:

- a- vlerat perkatese te aksionit dhe raporti I kembimit te aksionit
- b- vlera e cdo kontributit,
- c- keto raporte jane te miratuar edhe nga Asambleja e Aksionereve.

EKZISTENCA E SE DREJTES TE PERPARESISE NE NENSHKRIM

Aksioneret ekzistues kane nje drejte perparese ne nenshkrimin e aksioneve te reja per cdo zmadhim te kapitalit me para ne dore, ne perpjestim me shumen e aksioneve qe ai zoteron ne momentin e zmadhimit te kapitalit(sipas nenit 155 te ligjit)

Por sipas vendimit date 05.07.2004, te Mbledhjes se Jashtezakonshme te Asamblese se Shoqerise "TEQJA INTERNATIONAL" Sh.A, (pika e pare e rendit te dites), ne zbatim te (neni 156 I ligjit) eshte vendosur se:

- Aksioneret ekzistues te shoqerise te heqin dore nga e drejta e perparesise ne nenshkrimin e ketyre aksioneve te reja, per te mundesuar hyrjen pa veshtersi te partnereve jashte shoqerise ne kapitalin e shoqerise, (ky vendim eshte marre pasi jane degjuar dy raporte te detyrueshme)

- Kete te drejte perparesie per nenshkrimin e aksioneve te reja te emetuara nga shoqeria ,aksionieret ekzistues te shoqerise, ja kane thene dhe njohin si aksionere te ri te shoqeise "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A. me seli ne Rogozhine.

-FONDIN SHQIPTARO - AMERIKAN TE NDERMARRJEVE, te krijuar sipas legjislacionit te Shtetit DELAWARE U.S.A , dhe me perfaqesi ne Tirane, me te drejten qe:

- FONDI SHQIPTARO- AMERIKANE , te beje shlyrjen me para ne dore te aksione te reja , duke paguar ne llogarin Bankare te Shoqerise, shumen prej 1.570.000 US\$,ose e konvertuar ne leke, ne shumen prej 158.649.000 leke dhe kjo derdhje eshte e vertetuar sipas certifikates se depozitimit I fondit ne Bankes Amerikane e Shqiperise date 06.09.2004 .

KAPITALI I SHOQERISE

Me nenshkrimin dhe shlyrjen e aksioneve te reja nga aksioneret ,kapitali I shoqerise ndryshon nga 620.000.000 leke (gjashteqinde enjzetet milion) leke ne 778.649.000 leke(shtateqinde e shtatedhjete e tetemije e gjashteqinde e dyzete e nente mije) e ndare ne aksione 778.649 aksione, me vlere nominale 1.000 leke.

Kapitali I shoqerise zoterohet nga aksionerte e meposhtem:

Nr	AKSIONERTE	% kapitalit	Nr aksioneve	Vlera nominale	Vlera e kapitalit
1	Dionis Teqja	8.13%	63.000	1.000	63.000.000
2	Shoqeria "A TEQJA" sh.p.k	71.5%	557.000	1.000	557.000.000
3.	Fondi Shqiptaro-Amerikane	20.37%	158.649	1.000	158.649.000
	TOTALI	100	778.649	1.000	778.649.000

KONTABILIZIMI I ZMADHIMIT TE KAPITALIT.

Zmadhimi I kapitalit themeltare me para, ka te beje me ndryshim e madhësisë të aktivitetit neto dhe të kapitaleve të veta të shoqërisë, sepse ka hyrje të kapitaleve të reja.

Per kete arsye me kryerjen e veprimeve ne aneksin tregtare ndryshimit te statutit dhe publikimit ligjore qe shoqeron kete ndryshim shoqëria "TEQJA INTERNATIONAL"SH.A do te beje kontabilizimin e zmadhimit te kapitalit ne bilancin kontabel dhe konkretishte:

BILANCI KONTABEL

AKTIVI

PASIVI

1	AQT	Vlefte	KAPTALET E VETA	Vlefte
A	Ndertesa	112.500.000	A. Kapitali I nenshkruar	778.649.000
B	Makineri dhe pajisje	557.000.000		
	TOTALI	620.000.000		
2	AKTIVET QARKULLUESE			
A	BANKA	158.649.000		
	TOTALI AKTIVIT	778.649.000	TOTALI PASIVIT	778.649.000

TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Sipas Kontrates se Dhurimit te Aksioneve date 05.07.2004,
Aksioneri Dionis Teqja , I cili zoteron 63.000 aksione ne kapitalin e shoqerise "TEQJA INTERNATIONAL"SH.A, I dhuron Aksionerit te ri "FONDIT AMERIKANO-SHQIPTARE", nje numer aksione prej 28.227 (njezete e tetemije e dyqinde e njezete e shtate) aksione, kjo kontrate eshte aprovuar edhe ne mbledhjen e asamblese se aksionereve sipas pikes 2 te vendimit date 05.07.2004.

Ne keto kushte ndryshon edhe raporti I zoterimit te aksioneve ne shoqeri si me poshte:

Nr	AKSIONERET	% Kapitalit	Nr aksioneve	Vlera nominale	Vlefta e kapitalit
1.	Dionis TEQJA	5 %	34.773	1.000	34.773.000
2	Shoqeria"A TEQJA"sh.p.k	71 %	557.000	1.000	557.000.000
3	FONDI AMERIKO- SHQIPTARE	24 %	186.876	1.000	186.876.000
	TOTALI	100 %	778.649	1.000	778.649.000

KONKLUZION

Si rezultat I verifikimeve te bera dhe duke patur parasyshe edhe hollesite e dhena me siper ne cmojme qe vlera neto kontabel e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise, kapitali i shoqerise, vlerat perkatese qe ju eshte dhene aksioni, raporti I I kembimit, eshte respektuar parimi e barazise se aksionereve, te gjitha keto ndryshime jane pasqyruar ne pasqyrat financiare ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontable qe I aneksohen keti raporti dhe perbene nje vleresim normal dhe te arsyeshem.

Dhe si perfundim te operacionit te zmadhimit te kapitalit, mendoje se misioni im mbi kete operacion ka perfunduar , ky projekte I paraqitete per miratim Asamblese se Aksionereve.

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

TIRANE me 20.06.2004

SHKEMBI /
Eksperte Kontabel e Autorizuar
SHKEMBI /
TIRANE me 20.06.2004

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " TEQJA INTERNATIONAL " SHA

V E N D I M

Nr.3 DATE 29.09.04

Ne Tirane, sot me date 29.09.2004 ,
Asambleja e Jashtezakonshme e aksionareve te shoqerise
" Teqja International " Sha,Z. Dionis Teqja, shoqeria "A. Teqja
"Shpk, Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve, me adresen Rr.
Deshmoret e 4 Shkurtit ", Kompleksi " Green Park ", Kulla 2, Kati
12, Tirane,perfaqesuar me prokuren e posacme Nr. 3927 Rep. Nr.
1218 Kol. Date 06.07.04 ,e leshuar ne zyren e noterise Tirane,
notere M.Sadushaj nga z. Martin Mata.

V E N D O S E M:

1. Miratimin e aktit te ekspertimit kryer nga ekspertja per
zmadhimin e kapitalit.
2. Miratimin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise ne shumen prej
158.649.000 Leke, duke shkuar ne shumen prej 778.649.000 leke.

3. Ndryshime ne statutin e shoqerise.

Neni 13 Paragrafi i pare dhe i dyte i nenit 13 ndryshohen si vijon:
Kapitali themeltar i shoqerise eshte Leke 778.649.000
(shtateqind e shtatedhjete e tete milion e gjashteqind e dyzet
e nente mije).

Kapitali eshte i ndare ne 778.649 aksione me vlere nominale
Leke 1.000 (njemije) secili, te nenshkruara dhe shlyera
teresisht nga aksionaret.
Aksionaret zoterojne kapitalin themeltar si me poshte:

- . Dionis Teqja 34.773 aksione
- . A.Teqja shpk, 557.000 aksione
- ...Fondi Shqiptaro- Amerikan i Ndermarrjeve, 186.876 aksione.

4. Depozitimi i buletinit i nenshkrimit te aksioneve te reja te
emetuara nga shoqeria date 05.07.2004.

5. Depozitimimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

AKSIONARET

FONDI SHQIPTARO- AMERIKAN I NDERMARRJEVE
Perfaqesuar me prokure nga

MARTIN MATA



"A. Teqja" Shpk

Dionis Teqja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " TEQJA INTERNATIONAL " SHA
KAVAJE

V E N D I M :

nr. 3 date 02.03.2005

Asambleja e Jashtezakonshme e aksionareve te shoqerise " Teqja International " Sha, Z. Dionis Teqja, shoqeria "A. Teqja " Shpk, Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve, me adresen RR. deshmoret e 4 Shkurtit ", Kompleksi " Green Park ", Kulla 2, Kati 12, Tirane, perfaqesuar me prokuren e posacme Nr. 3927 Rep. Nr. 1218 Kol. Date 06.07.04 , e leshuar ne zyren e noterise Tirane, notere M.Sadushaj nga z. Martin Mata,

Sot me date 02.03.2005, zhvillohet mbledhja e jashtezakonshme e shoqerise " Teqja International " sha, Kavaje, ne te cilen u vendos:

1. Te behet kalimi ne bilancin e shoqerise " Teqja International " sha te gjithe pasurine e transferuar (aktive dhe detyrime) si rezultat i operacionit te ndarjes (mylljes) te shoqerise "A. Teqja" shpk Kavaje, sipas bilancit te bashkengjitur.
2. Te emeroje Zj. Ajeta Shkambi si eksperte kontabel e autorizuar, per te ndjekur operacionin e ndarjes dhe transferimin e pasurise se shoqerise.
3. Depozitimin e vendimit ne zyren e regjistrimit tregtar.

A k s i o n e r e t

FONDI AMERIKAN
I NDERMARRJEVE
PERFAQESUAR ME PROKURE

DIONIS TEQJA

SHOQERIA " A.TEQJA"

perfaqesuar nga
Dionis Teqja

Martin Mata
M. Mata



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 4173 Rep.

Nr. — Kol.

VERTETIM


Sot ne Tirane, me date 18 05.2005 (dymije e pese) para meje Noter
Fatmara Shehu, me seli ne Bul. « Gjergj Fishta», u paraqiten:

KERKUESIT:

1. **Dionis Teqja**, administrator i shoqerise « A. Teqja »
2. **Dionis Teqja**, dhe **Martin Mata**, perfaqesues i « Fondit Amerikan i Ndermarrjeve » me
prokuren e posacme Nr. 3927 Rep, nr. 1218 Kol. date 06.07.04 e leshuar ne zyren e noterise
Tirane, notere M. Sadushaj, te dy aksionere te shoqerise « Teqja International » sha

Madhore ,me zotesi te plote juridike per te vepruar, deklarojne se
sa siper, kane nenshkruar me vullnetin e lire dhe konforme
vullnetit tyre,une noteri nenshkruaj rregullisht.

NOTER



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " TEQJA " SHPK
KAVAJE

V E N D I M

Sot ne Tirane, me date 02.03.2005, zhvillohet mbledhja e jashtezakonshme e shoqerise " TEQJA " shpk Kavaje, ne te cilen u vendos:

V E N D I M

1. Te behet kalimi ne bilancin e shoqerise " TEQJA " te gjithë pasurine e transferuar (aktive dhe detyrime) si rezultat i operacionit te ndarjes (mbylljes) te shoqerise " A. Teqja " shpk Kavaje, sipas bilancit te bashkengjitur:
2. Te emeroje zj. Ajeta Shkambi si eksperte kontabel e autorizuar, per te ndjekur operacionin e ndarjes dhe transferimin te pasurise se shoqerise.
3. Depozitimin e vendimit ne zyren e regjistrarit tregtar.

Shoqeria " TEQJA " shpk
Dionis Teqja



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA ENOTERISE TIRANE
NR. REP. 4171

W.W. 473

V E R T E T I M

Ne Tirane, sot me date 18 05.2205 (dymije e pese),
para meje noter Fatmara Shehu, me seli ne Bul. " Gjergj
Fishta ", u paraqit:.....


KERKUESI:

Dionis Teqja, administrator i shoqerise " TEQJA " SHPK,
Rregjistruar ne gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr.
32776 date 19.02.2005, me seli ne Rrogozhine,

Madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i
cili deklaroi se sa siper, ka nenshkruar me vullnetin e
lire, une noteri nenshkruaj sipas ligjit.

N O T E R

FATMARA SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "A. TEQJA " SHPK
KAVAJE

V E N D I M

NR. 2 DATE 02.03.2005


Sot me date 02.03.2005, Une ortaku i vetem i shoqerise " A. teqja " shpk, ne mbedhjen e jashtezakonshme te shoqerise "A. Teqja " shpk, Kavaje,

V E N D O S A

1. Te bahet ndarja e shoqerise " A. TEQJA " shpk dhe mbylljen e saj pa likuidim.
2. Te behet transferimi universal i pasurise tek shoqeria perfituese " Teqja International " sha dhe ne shoqerine " TEQJA " shpk, sipas bilanceve te bashkengjitura.
3. Te emeroje si eksperte kontabel e Autorizuar per te realizuar operacionin e ndarjes (mbylljes pa likuidim) zj. Ajeta Shkambi.
4. Depozitimin e ndryshimeve ne zyren e regjistrimit tregtar.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE " A. TEQJA " SHPK

DIONIS TEQJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA ENOTERISE TIRANE
NR. REP. 4172

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 18.05.2205 (dymije e pese),
para meje noter Fatmara Shehu, me seli ne Bul. " Gjergj
Fishta ", u paraqit:.....


KERKUESI:

Dionis Teqja, administrator i shoqerise "A. TEQJA " SHPK,
Rregjistruar ne gjykatën e rrethit Tirane me vendimin nr.
13668 date 6.02.1996, me seli ne Rrogozhine,

Madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i
cili deklaroi se sa siper, ka nenshkruar me vullnetin e
lire, une noteri nenshkruaj sipas ligjit.

NOTER

FATMARA SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A
KAVAJE


V E N D I M

Sot me date 02.05.2005, u be mbledhja e Jashtezakonshme e Shoqerise "TEQJA INTERNATIONAL" SH.A. Kavaje ne te cilen u vendose:

1. Te beje kalimin ne bilancin e Shoqerise "TEQJA INTERNATIONAL" te gjithe pasurine e transferuar (aktive dhe detyrime) si rezultat I operacionit te ndarjes (mbylljes) te Shoqerise "A.TEQJA" sh.p.k Kavaje ,sipas bilancit te bashkengjitur.
2. Te miratoje raportin Zj. Ajeta Shkambi si Eksperte Kontabel e Autorizuar, per realizimin e operacionit te ndarjes.
3. depozitimn e vendimit ne regjistrin tregatre.

AKSIONERET


FONDI AMERIKAN



DIONIS TEQJA



SHOQERIA "A.TEQJA"



VERTETIM


Sot ne Tirane, me date 14 06.2005 (dymije e pese) para meje Noter
Fatmara Shehu, me seli ne Bul. « Gjergj Fishta», u paraqiten:

KERKUESIT:

1. **Dionis Teqja**, administrator i shoqerise « A. Teqja »
2. **Dionis Teqja**, dbe 3. **Martin Mata**, perfaqesues i « Fondit Amerikan i Ndermarrjeve » me
prokuren e posacme Nr. 3927 Rep, nr. 1218 Kol. date 06.07.04 e leshuar ne zyren e noterise
Tirane, notere M. Sadushaj,
te dy aksionere te shoqerise « Teqja International » sha, te njohur prej meje..

Madhore ,me zotesi te plote juridike per te vepruar, deklarojne se
sa siper, kane nenshkruar me vullnetin e lire,une noteri
nenshkruaj rregullisht.

NOTER



REPUBLIKA E SHQIPERISE

V E N D I M
